



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.08-55**  
**03.03.2025**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 80 paragrafi (5) nga Ligji i njëjtë, neni 51 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe neni 52 paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.96/19), neni 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-55 datë 14.02.2025, për iniciimin e procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr.08-55 datë 27.02.2025, për miratimin e vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr. 02-799/7 datë 28.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025 miratoi:

**VENDIM**  
**për marrjen e lejesë për transmetim televiziv të**  
**Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup**

1. I HIQET leja për transmetim televiziv, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023 të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, për shkak të kompensimit vjetor të papaguar të lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor prej – 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës me nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (ark.nr.05-137/1 datë 10.01.2025)
2. Fatura me nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (ark.nr.05-137/1 datë 10.01.2025), anulohet dhe subjektit nga pika 1. i këtij Vendimi, i jepet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht nga dita e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes, që duhet paguar jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e lejes së dhënë.
3. Vendimi publikohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
4. Ky Vendim është përfundimtar.

**A r s y e t i m**

Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, është zotëruar i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, për

transmetim nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, në nivel rajonal, për zonën D1- Crn Vrv - Shkup (Shkup, Petrovec, Haraçinë, Çuçev Sandevë, Sopishtë, Studeniçan, Zelenikovë dhe Ilinden), shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën rome dhe në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me nenin 80 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), për lejen e transmetimit televiziv ose radio, transmetuesit me përjashtim të shërbimit publik transmetues, paguajnë kompensim vjetor në llogarinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me ligjin. Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes për transmetim televiziv ose radio në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia (neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV).

Në lidhje me kompensimin për lejen e transmetimit televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiofuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, Agjencia me datë 10.01.2025 dërgoj Faturën me nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (ark.nr.05-137/1 datë 10.01.2025) për kompensimin e lejes, sipas së cilës transmetuesi kishte për detyrim të paguajë 1.240.182,00 (një milion e dyqind e dzyetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) denarë për kompensim vjetor për lejen për transmetim televiziv, për periudhën nga data 05.01.2025 deri më datë 04.01.2026. Në Agjenci në vendin e Librit është shënuar se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt me datë 13.01.2025.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, për punën e botuesve të medias në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe dispozitave miratuar në bazë të Ligjit (neni 29 paragrafi (1) të LSHMAAV).

Agjencia, përmes Sektorit për financa dhe logjistikë, kryen mbikëqyrje administrative të punës së Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, në aspekt të përmbushjes së detyrimeve për pagesën e kompensimit vjetor të lejes, nga ku pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative (ark.nr.05-661/1 datë 14.02.2025), është konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në llogarinë e Agjencisë.

Pikërisht, sipas Faturës së dorëzuar nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (ark.nr.05-137/1 datë 10.01.2025), Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, kishte detyrim të paguajë 1.240.182,00 (një milion e dyqind e dzyetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) denarë për kompensim vjetor të lejes për transmetim televiziv, për periudhën nga 05.01.2025 deri më 04.01.2026. Përfundimisht me 11.02.2025, që ishte afati i fundit ligjor për pagesën e kompensimit të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, nuk ka kryer pagesë në shumë prej 1.240.182,00 (një milion e dyqind e dzyetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) denarë.

Në nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të LSHMAAV është përcaktuar se nëse konstatohet mosrespektim, cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore, të miratuara me ligj, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë, kundër botuesi të medias, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të LSHMAAV, Agjencia do të marrë lejen për transmetim televiziv ose radio, para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve, paraprakisht duke dorëzuar njoftim me shkrim, nëse zotëruesi i lejes nuk e paguan kompensimin për lejen në afatin e përcaktuar ligjor.

Procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv ose radio, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LSHMAAV, e inicon Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Duke pasur parasysh gjendjen e përcaktuar faktike, sipas së cilës zotëruesi i lejes, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, në aftin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk

ka përmbushur detyrimin e nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, përkatësisht zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin e lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor, Drejtori i Agjencisë, në bazë të nenit 83 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të LSHMAAV, dorëzoi Propozimin PA1 nr.08-55 datë 14.02.2025, për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 7-të, mbajtur më 18.02.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-657/12 datë 18.02.2025, e miratoi Propozimin, PA1 nr.08-55 datë 14.02.2025, për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.

Në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia i dërgoi njoftim transmetuesit në fjalë (PA1 nr.08-55 datë 19.02.2025), në të cilin theksohet se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr.08-55 datë 14.02.2025, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, dhe në pajtim me nenin 85 paragrafi (2) të LSHMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimi PA1 nr.08-55 datë 19.02.2025, u dorëzua me shkrim drejtuar Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, ku në vendin e Librit të Agjencisë është shënuar se është pranuar në mënyrë të rregullt më 20.02.2025, nga transmetuesi në fjalë. Njëkohësisht, njoftimi në fjalë është dërguar më 19.02.2025 dhe me e-mail në adresën zyrtare elektronike të transmetuesit regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV-së dhe në regjistrin e transmetuesve të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Duke pasur parasysh faktin se zotëruesi i lejes Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, dhe në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të Propozimit PA1 nr.08-55 datë 14.02.2025, nga ana e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, Drejtori i Agjencisë, dorëzoi Propozimin PA1 nr.08-55 datë 27.02.2025, sipas të cilit Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 dhe neni 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, ark.nr.02-799/7 datë 28.02.2025, miratoi Vendim me të cilën i hiqet leja PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023 për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, për faktin se zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin e lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë, nëse zotëruesi i lejes për transmetim televiziv ose radio nuk kryen pagesën e kompensimit, sipas faturës së dotëzuar në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni të Rregullores, anulohet dhe i jipet faturë e re e cila i referohet vetëm periudhës së punës, që duhet paguar jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së faturës. Në të kundërtën pagesa e borxhit, kryhet në rrugë gjyqësore.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Fatura nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (ark.nr.05-137/1 datë 10.01.2025) për kompensimin e lejes për transmetim televiziv, anulohet dhe Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, i jipet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes dhe që duhet të pagohet jo më vonë se dita e 8 (tetë) nga dita e dhënies së saj.

Në pajtim me nenin 84 të LSHMAAV, vendimi për heqjen e lejes për transmetim televiziv është përfundimtar, ndërkaq kundër këtij vendimi, zotëruesi i lejes ka të drejtë të paraqesë padi për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të tij. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lart, u miratua Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi për heqjen e lejes, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, ka të drejtë të paraqesë padi për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.